

VENDIM
Nr. 958, datë 29.12.2014

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2014 PËR
MINISTRINË E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS, BRENDË PROGRAMIT
PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “REHABILITIMI DHE KTHIMI NË GJENDJEN
FILLESTARE TË RRUGËVE KU NDËRTOHET RRJETI I KANALIZIMEVE TË
UJËRAVE TË PËRDORURA”, NË KUADËR TË PROJEKTIT “KANALIZIME TË
UJËRAVE TË PËRDORURA, KORÇA IV, IPA 2010”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës dhe ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2014 për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës bëhet ri-shpërndarja e fondeve, si më poshtë vijon:

a) Në programin buxhetor 06370 “Furnizimi me ujë dhe kanalizime”, shpenzime kapitale pakësohet fondi prej 170 987 049 lekësh (njëqind e shtatëdhjetë milionë e nëntëqind tetëdhjetë e shtatë mijë e dyzet e nëntë lekësh), për Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjetllës - Kanalizimeve, nga projekti me kod M062547;

b) Në programin buxhetor 06370 “Furnizimi me ujë dhe kanalizime”, shpenzime kapitale shtohet fondi prej 170 987 049 lekësh (njëqind e shtatëdhjetë milionë e nëntëqind tetëdhjetë e shtatë mijë e dyzet e nëntë lekësh), për financimin e projektit “Rehabilitimi dhe kthimi në gjendjen fillestare të rrugëve ku ndërtohet rrjeti i kanalizimeve të ujërave të përdorura”, në kuadër të projektit “Kanalizime të ujërave të përdorura, Korça IV, IPA 2010”, për Ujësjetllës -Kanalizime sh.a., Korçë.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës - Kanalizimeve dhe Ujësjetllës - Kanalizime sh.a., Korçë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama